



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës

20.09.2024

NJOFTIM

**"NDARJA E SEKSIONIT PENAL DHE SEKSIONIT CIVIL
TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës"**

SEKSIONI CIVIL



SEKSIONI CIVIL

Adresa: Lagja Nr. 14, Rruga: "Bajram Tusha",

Shkozë, Durrës

Tel: 00355 52 234

E-mail: zmp.gjykatarrëthitdurrës@gjykata.gov.al

Map: https://www.google.com/maps/place/Gjykata+e+Apelit+Durrës/@41.3273808,19.4872363,17z/data=!3m1!1e3!1m1!1s0x134fd9ef6790adad:0x8cb5d2398864862!8m2!3d41.3273768!4d19.4898112!16s%2Fg%2F11b6ytd5xm?entry=tu&g_ep=EgoyMDI0MDkxOC4xIKXMDSoASAFAw%3D%3D

**TË GJITHA ÇËSHTJET CIVILE
QË JANË AKTUALISHT NË SHQYRTIM
SI DHE ÇËSHTJET CIVILE
TË REGJISTRUARATË REJA
DO TË GJYKOHEN
PRANË GODINËS
TË ISH-GJYKATËS SË APELIT Durrës,
PREJ DATËS 30.09.2024**

SEKSIONI PENAL



SEKSIONI PENAL

Adresa: Lagja Nr. 2,

Rruga "Aleksandër Goga", Durrës

Tel: 00355 52 234362

E-mail: zmp.gjykatarrëthitdurrës@gjykata.gov.al

Map: https://www.google.com/maps/place/Durrës/@41.315682,19.444993,13z/data=!4m6!3m5!1s0x134fda48bdac224b:0x1a6540efbf925e0e!8m2!3d41.315682!4d19.4449928!16s%2Fg%2F1hd_hkqfw?hl=enUS&entry=tu&g_ep=EgoyMDI0MDkyMi4wIKXMDSoASAFAw%3D%3D

**TË GJITHA ÇËSHTJET PENALE
QË JANË AKTUALISHT SHQYRTIM
SI DHE ÇËSHTJET PENALE
TË REGJISTRUARATË REJA
DO TË GJYKOHEN
PRANË GODINËS AKTUALE
TË GJYKATËS.**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Lagja Nr. 14, Rruga: "Bajram Tusha", Shkozë, Durrës

Lagja Nr. 2, Rruga: "Aleksandër Goga", Durrës, Tel/Fax: +3555234362,

Seksioni Civil

Seksioni Penal

Për të gjithë përdoruesit e Gjykatës

Nga e hëna në të premte

Ora 08:00 – 16:00

SPORTELI do të ofrojë **SHËRBIME** si më poshtë:

1. Depozitim Kërkesa penale dhe akte të tjera procedurale/provuese në numër sa janë palët ndërgjygjëse;
2. Depozitim Kërkesëpadi dhe akte të tjera procedurale/provuese në numër sa janë palët ndërgjygjëse;
3. Kërkesat për plotësim, sqarim, interpretim vendimi dhe ndreqje gabimi
4. Kërkesë për kopje vendimi/akteve nga Zyra e Arkivës;
5. Kërkesë për kopje të akteve për çështje gjyqësore në proces;
6. Ankimet/kundërankimet;
7. Kërkesë për vërtetim mbi çështjet e gjykuara apo në gjykim;
8. Kërkesë për informacion mbi çështjet e regjistruar në gjykatë;
9. Kërkesë për përshpejtim të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
10. Kërkesat për depozitim të dhënave të kontaktit të palëve apo përfaqësuesve të tyre për çështjet gjyqësore në proces si dhe çdo të dhënë për ndryshimin e adresave të vendbanimit;
11. Depozitim të aktit të përfaqësimit të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
12. Kërkesa për përjashtim të trupi gjykues në çështjet civile/penale
13. Kërkesat për heqje dorë nga ankimi;
14. Kërkesat për informacion të publikut dhe medias;
15. Kërkesat për çështjet gjyqësore në proces;
16. Aplikime, etj.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

Taksat/Tarifat e shërbimeve gjyqësore

Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore:		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
1	Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit.	200	
2	Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit.	200	
3	Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	200	
4	Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Punëve të Jashtme	200	
5	Për lëshimin e vërtetimit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria.	200	
6	Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria	200	
7	Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor.	200	
Kërkesëpadi që paraqiten në gjykatë:			
	a) padi për pension ushqimor	0	
	b) padi për vërtetim fakti	200	
	c) padi për zgjidhje martese	3000	
	ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000	
8	d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi:		
	I) me vlef të deri 100 000 lekë	3000	
	II) me vlef të mbi 100 000 lekë		1%
	dh) padi për pjesëtim pasurie	3000	
	e) padi për kthim në punë	0	
9	Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës	200	
10	Për lëshimin e kopjeve CD AUDIO të seancave gjyqësore	200	
11	Fotokopje të akteve gjyqësore	10 lek/faqe + 100 lek shërbimi	
12	Transkriptimi i një fragmenti nga procesverbali i seancës gjyqësore	500 lek	
13	Transkriptimi i një procesverbali i seancës gjyqësore	1500 lek	

FATURA PËR ARKËTIM
Nr. _____, Datë _____

Me anë të kësaj fature kërkojme që Banka Juaj të pranojë nga klientë (persona / persona fizik/ persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogaritë institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe Shumat si më poshtë :

Emri I Institucionit përfitues	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	
Kodi I Institucionit	1029015	
Kodi I Deges se Thesarit ku vepron	707	

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që arkëtohet në Lekë
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
1	DEPOZITIME NË RUAJTJE TË VITIT NË VAZHDIM	4665100	4,500
2	TË ARDHURA NGA TAKSA GJYQËSORE 10%	7112100	500
	PADITES :		
	I PADITUR :		
	OBJEKTI : 500'000 LEKË		
	TOTALI		5000

INSTITUCIONI

KLIENTI

KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër¹: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/202__ Nënshkrimi: _____
---	---	--

Autoriteti Publik :
Adresa:
Qyteti:

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____

Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: __/__/2020	Numri rendor i kërkesës: _____	Komente: _____ _____ _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
--

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, [portalit pyetshtetin.al](http://portalit.pyetshtetin.al) apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit pyetshtetin.al
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
01	02.01.2025	Kërkesë /info mbi çështjen me interes publik lidhur me vrasjen e shtetasit P.G, në Durrës. Info për zhvillimin/ndjekjen e seancës "Vlefësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit F. J. i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Vrasje me dashje", e mbetur e tentative, "Vrasje me dashje", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja e armëve të ftohta", të parashikuar nga neni 76 e 279/1 K.Penal". Kërkues: Gazetare V.Qyrfyçi	02.01.2025	Nga verifikimet e kryera në Sistemin ICMIS rezultojnë se: Pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja penale Nr. 2 Akti, me objekt: "Vlefësim i ligjshëm i arrestit. Caktim i masës së sigurimit personal ndaj shtetasit F.J". Gjyqtari i çështjes- R.Bekteshi. Seanca u zhvillua më datë 02.01.2025, ora 09.15. Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka Vendosur: 1. Vlefësimin e ligjshëm të ndalimit i datës 31.12.2024, ora 13:30 të shtetasit F.J., i dyshuar për veprën penale të "Vrasjes me dashje" të shtetasit P.G. dhe të "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje të	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes (e përmbledhur) duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

FORMULAR ANKESE

Drejtuar
Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Emri / Mbiemri¹ :	
Adresa:	
Qyteti :	
Telefon:	
E-mail:	

Autoriteti Publik :
Adresa:
Qyteti:

Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankoheni.

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhini ato.

Përshkruani çfarë kërkonte nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014.

(Data) _____

(Firma) _____

Formulari i ankesës duhet të shoqërohet me formularin e kërkesës për informim drejtuar Autoritetit publik si dhe recetën postare ose emailin drejtuar Autoritetit Publik.

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose koordinatorin e të drejtës për informim.

¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më __.__.2023

VENDIM

Nr. 716, Datë 06.12.2023

PËR

**MIRATIMIN E UDHËZUESIT STANDARD TË MARRËDHËNIEVE TË
GJYKATAVE ME PUBLIKUN DHE MEDIAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në të nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 91, 97, 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenet 5, 46, 50 të Ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e shqipërisë", nenet 103, 104, 105, 339, 340 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 26, 173 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 36, 43 të Ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, nenet 2, 3, 7, 10, 14, 15, 17 të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar, nenet 2, 4, 6 pika 2, 8, 21 pika 3, 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Administrimit, Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit,

V E N D O S I

1. Të miratojë "Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median" sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

UDHËZUESI STANDARD I MARRËDHËNIEVE TË GJYKATAVE
ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Udhëzuesi standard për marrëdhëniet e gjykatës me publikun e median përcakton rregullat dhe procedurat e informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase.
2. Udhëzuesi synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median.

Neni 2

Parimet

1. Marrëdhënia e gjykatës me publikun dhe median bazohet në parimet e aksesit të barabartë në gjykata, karakterit publik të procesit gjyqësor, hapjes maksimale të veprimtarisë gjyqësore ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit, si dhe prezumimit të pafajësisë.
2. Komunikimi i gjykatës me publikun dhe median duhet të jetë i besueshëm, transparent, objektiv, i paanshëm, i balancuar, i matur, koherent, si dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke shmangur krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privileguara me përfaqësues të caktuar të saj.
4. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik që administrohet nga gjykata, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

5. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
6. Gjykata është e detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
7. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me rregullimet e Ligjit "Për të drejtën e informimit".

KAPITULLI II

SHËRBIMET PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN DHE METODAT E KOMUNIKIMIT

Neni 3

Shërbimet për marrëdhëniet me publikun dhe median

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun dhe median ushtrohen nga gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median dhe nëpunësi civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun dhe median.
2. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, përgjegjës për marrëdhëniet me publikun dhe median, bashkëpunon me gjyqtarin e caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median për mbajtjen e qëndrimeve publike, për unifikimin dhe standardizimin e komunikimit me publikun dhe median, si dhe kujdeset të përçojë misionin dhe vizionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 4

Gjyqtari për marrëdhëniet me publikun dhe median

1. Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median ushtron funksionet e mëposhtme:
 - a) Ushtron veprimtarinë e shërbimit me publikun dhe median nëpërmjet nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe median;
 - b) Koordinon veprimtarinë me gjyqtarin e çështjes dhe kryetarin e gjykatës në rastet me interes të veçantë publik;
 - c) Shërben si zëdhënës për gjykatën në rastet e çështjeve me rëndësi të veçantë për publikun dhe median, duke shpjeguar procedurat e ndjekura nga gjykata, pa dhënë komente mbi zgjidhjen e çështjes;
 - ç) Përgatit projektdeklaratën publike dhe bashkëpunon me anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjegjës për marrëdhëniet e publikut dhe median për mbajtjen e qëndrimeve publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë, në zbatim të ligjit;

- d) Bashkëpunon me gjyqtarët e tjerë për marrëdhëniet me publikun e median, kryetarët e gjykatave dhe kancelarët për unifikimin e mënyrave dhe formave të dhënies së informacionit;
 - dh) Udhëzon nëpunësin për marrëdhëniet me publikun dhe median mbi procedurat e dhënies së informacionit, apo të komunikimit me mediat, nëse nuk ushtrohen drejtpërdrejt prej tij;
 - e) Jep intervista në media apo konferenca për shtyp për informimin e publikut dhe medias për çështje me interes të veçantë publik, ose në rast të konstatimit të informacioneve të pasakta të publikuara në media;
 - ë) Organizon takime e prezantime periodike me përfaqësuesit e medias, me qëllim vendosjen e komunikimit të përditshëm.
2. Kur gjyqtari për marrëdhëniet me publikun dhe median është njëkohësisht gjyqtari i çështjes me interes të veçantë publik, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor është përgjegjës për komunikimin publik të çështjes.

Neni 5

Nëpunësi për marrëdhëniet me publikun dhe median

1. Nëpunësi për marrëdhëniet me publikun dhe median ushtron detyrat e mëposhtme:
 - a) Siguron, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimin e gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun dhe median, informimin e publikut dhe medias mbi veprimtarinë gjyqësore;
 - b) Mban funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe përgatit e publikon Programin e Transparencës, në bashkëpunim me sektorët e tjerë;
 - c) Përgatit dokumente strategjike dhe/ose politikë të gjykatës, në lidhje me mënyrën e zhvillimit të mëtejshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënies dhe komunikimit me publikun dhe median;
 - ç) Informon në mënyrë sistematike gjyqtarin për marrëdhëniet me publikun dhe median për interesin e paraqitur nga mediat mbi një çështje gjyqësore të caktuar;
 - d) Harton nën mbikëqyrjen e gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun dhe median dhe bën publike komunikatat për shtyp për çështje që i përkasin veprimtarisë së gjykatës dhe i dërgon ato, sipas rastit, për botim apo transmetim;
 - dh) Harton përgjigjet me shkrim ndaj kërkesave për informim dhe, kur e gjykon të nevojshme, konsultohet edhe me nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë në gjykatë;
 - e) Mban regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në përputhje me ligjin;
 - ë) Vepron si pikë kontakti për përfaqësuesit e medias, duke krijuar marrëdhënie korrekte dhe të ndërsjella, si dhe zbaton detyrimet që burojnë nga ligji për informimin publik, duke iu përgjigjur interesimit të medias për probleme që lidhen me veprimtarinë e gjykatës;
 - f) Siguron që t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;
 - g) Siguron tërheqjen e shtypit të përditshëm dhe harton një përmbledhje ku evidentohen problemet që paraqesin interes e që lidhen me sistemin e drejtësisë, me veprimtarinë gjyqësore në përgjithësi dhe posaçërisht me atë të gjykatës ku ushtron funksionin, duke ia paraqitur Këshillit të Gjykatës dhe gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun e median;

- gj) Organizon konferenca shtypi apo raportime, sipas udhëzimeve të kryetarit të gjykatës dhe/ose gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun dhe median;
- h) Organizon, sipas udhëzimeve të gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun dhe median, takime periodike me mediat, me qëllim prezantimin e përmbledhjeve të veprimtarisë së gjykatës, si dhe objektivave për të ardhmen;
- i) Kujdeset dhe ndërmerr veprimet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve pranë gjykatës, merret me çështje të bashkërendimit paraprak dhe realizimit të tyre, kujdeset për protokollin, si dhe kryen detyra të tjera në funksion të aktiviteteve;
- j) Bashkëpunon me sektorët e tjerë për përditësimin e informacionit të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, si dhe në platformat e mediave sociale;
- k) Harton materialet informuese të gjykatës, duke u përqendruar veçanërisht në të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, të të miturve viktime ose dëshmitarë të veprave penale, pakicave etnike, grupeve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, i përditëson ato sipas nevojës dhe ofron ndihmesë teknike për sektorë të tjerë të gjykatës lidhur me publikimet, broshurat apo fletëpalosjet;
- l) Ndjek seanca gjyqësore ku ka prani mediatike dhe kujdeset për mbarrëvajtjen e pjesëmarrjes së medias;
- ll) Kryen detyra të tjera, sipas parashikimeve të rregullores së gjykatës, udhëzimeve të kryetarit, gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun dhe median dhe/ose kancelarit.

Neni 6

Mënyrat dhe format e komunikimit me publikun dhe median

1. Komunikimi publik i gjykatës mund të realizohet në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - a) Njoftimi për media;
 - b) Konferencë për media;
 - c) Intervistë;
 - ç) Përgjigje me shkrim për kërkesat për informim;
 - d) Deklaratë zyrtare;
 - dh) Debat televiziv në median audiovizuale;
 - e) Video mesazh;
 - ë) Tryezë e rrumbullakët.
2. Format bashkëkohore të komunikimit përfshijnë ndërveprimin e drejtpërdrejtë të gjykatave me publikun, përmes faqes zyrtare në internet të gjykatës dhe rrjeteve sociale.
3. Me qëllim ofrimit të informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, format bashkëkohore të komunikimit, krahas Programit të Transparencës, ofrojnë informacion të detajuar mbi:
 - a) Strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, funksionet dhe detyrat e drejtuesve të gjykatës, listën emërore të gjyqtarëve dhe jetëshkrimin e tyre;
 - b) Natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, kuadrin rregullator në fuqi mbi të cilat bazohet funksionimi dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe orientimi në gjykatë;
 - c) Rregulloret e miratuara dhe në fuqi të gjykatës, procesverbalet dhe aktet e miratuara nga Këshilli i Gjykatës ose Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve;
 - ç) Aksesin fizik të gjykatës nëpërmjet publikimit të adresës së gjykatës dhe mundësive të kontaktimit;

- d) Listën e tarifave të shërbimeve që ofron gjykata;
- dh) Ndihmën juridike falas dhe informacion të përgjithshëm se si mund të përfitohet;
- e) Listën emërore të avokatëve kryesisht, ekspertëve dhe ndërmjetësve që ushtrojnë veprimtarinë pranë gjykatës;
- ë) Mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- f) Paditë e regjistruara, që përfshin kohën e regjistrimit, palët në gjykim (të anonimizuara), llojin e çështjeve, bazën ligjore, gjyqtarin e çështjes, datën dhe orën e seancës gjyqësore, statusin e gjykimit të çështjes dhe përfundimin e saj;
- g) Ndarjen me short elektronik apo manual të çështjeve gjyqësore;
- gj) Listën vjetore të gatishmërisë së gjyqtarëve për çështjet me natyrë urgjente;
- h) Seancat gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të tyre nëpërmjet publikimit të listës së çështjeve në gjykim, kalendarit të seancave gjyqësore dhe historikut të seancave;
- i) Publikimin e dispozitivit dhe vendimeve përfundimtare të marra nga gjykata;
- j) Kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, raportet vjetore të performancës dhe evidencat periodike statistikore;
- k) Publikimin e njoftimeve me afishim publik;
- l) Formularët tip për kërkesat e ndryshme drejtuar gjykatës;
- ll) Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- m) Regjistrin e kërkesave për të drejtën e informimit dhe përgjigjeve ndaj tyre;
- n) Të dhënat për shpenzimet gjyqësore dhe buxhetet;
- nj) Transparencën financiare, si strukturat e pagave të stafit të gjykatës, buxheti aktual, raporti i monitorimit të shpenzimeve për vitin më të fundit financiar të analizuar, raporti i fundit i auditimit të brendshëm, lista e kontratave të lidhura momentalisht me palë të treta (shërbime të kontraktuara ose tenderuara), shuma e kontraktuar, palët kontraktuese, përshkrimi i mallrave ose shërbimeve të kontraktuara, plani i zbatimit (afatet kohore) dhe monitorimi i tyre, raporti i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose organe të tjera mbikëqyrëse;
- o) Çështje të tjera me interes publik.

Neni 7

Komunikimi në situata të veçanta kritike

1. Situata kritike konsiderohen ato situata, të cilat kërkojnë komunikim të shpejtë dhe të përshtatshëm nga gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median, si më poshtë:

- a) Ngjarje me ndjeshmëri të lartë publike;
- b) Publikimi i informacionit të pasaktë për çështjet në proces, veçanërisht kur ky publikim përbën një kërcënim të menjëhershëm për funksionimin ose reputacionin e një institucioni gjyqësor;
- c) Sulmet publike kundër gjykatës në përgjithësi;
- ç) Sulmet publike ndaj gjyqtarëve.

2. Gjyqtari për marrëdhëniet me publikun dhe median reagon për situatat kritike sipas pikës 1, edhe kur këtë e kërkon një grup prej jo më pak se pesë përfaqësues të medias.

3. Sipas situatës, gjyqtari për marrëdhëniet me publikun dhe median, ndjek hapat e mëposhtme:

- a) Përgatit një përmbledhje të shkurtër informuese për situatën aktuale dhe veprimet e ndërmarra;
- b) Njofton publikisht përmbledhjen, duke ofruar versionin zyrtar të situatës;
- c) Komunikon me anëtarin e KLGJ-së përgjegjës për marrëdhëniet me publikun dhe median, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij udhëzuesi;
- ç) Përgatit deklaratën, pasi merr mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për rastin e sulmeve publike, sipas germës "c" të pikës 1 të këtij neni.

4. Komunikimi me median, sipas pikës 1 të këtij neni, synon:

- a) Të informojë për situatën aktuale dhe veprimet e miratuara;
- b) Të sigurojë ose të paralajmërojë publikun;
- c) Të korrigjojë dhe rregullojë informacionin e pasaktë;
- ç) Të rivendosë faktet dhe të shpjegojë rrethanat ligjore;
- d) Të ruajë ose rikthejë besimin tek autoriteti gjyqësor;
- dh) Të ruajë ose rikthejë reputacionin e gjyqtarëve.

KAPITULLI III

AKSESI NË VENDIMET GJYQËSORE DHE TË DHËNAT E TJERA TË GJYKATËS

Neni 8

Parimet e dhënies së informacionit mbi dokumentet zyrtare të gjykatës

1. Informacioni i gjykatës ndahet në informacion që vihet në dispozicion pa kërkesë dhe me kërkesë.

2. Publikimi i informacionit pa kërkesë bëhet nga gjykata, duke vlerësuar interesin dhe të drejtat e publikut për t'u informuar mbi veprimtarinë e gjykatës.

3. Informacioni pa kërkesë publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës, si dhe në çdo botim apo burim të informimit publik. Kategoritë e informacionit pa kërkesë, pavarësisht nëse është publikuar ose jo, jepen nga gjykata pa asnjë kufizim.

4. Gjikata jep informacion me kërkesë, vetëm sipas parimeve dhe procedurave që parashikojnë ligjet përkatëse për kufizimin e dhënies së informacionit.

Neni 9

Të dhënat pa kërkesë

1. Të dhënat që vihen në dispozicion pa kërkesë përfshijnë informacione apo dokumente të cilat nuk ndalohen me ligj të bëhen publike.

2. Konsiderohen të dhëna që vihen në dispozicion pa kërkesë, të dhënat e parashikuara në nenin 6, pika 3 të këtij udhëzuesi.

3. Përveç formave bashkëkohore të komunikimit të parashikuara në nenin 6, pika 2 të këtij udhëzuesi, këto të dhëna vihen në dispozicion edhe duke plotësuar një formular aplikimi. Formulari është i aksesueshëm lehtësisht në faqen e internetit të gjykatës, ose

fizikisht në sportelet e shërbimit ndaj publikut në gjykatë. Formulari mund të dërgohet edhe *online*, kur ky shërbim ofrohet nga gjykata përkatëse.

4. Informacioni jepet sipas formatit të kërkuar. Kur ky informacion është botuar në formë broshurash dhe çmohet se materiali i botuar plotëson objektin e kërkesës, atëherë gjykata e ofron informacionin në atë format. Gjykata mund të japë informacion që vihet në dispozicion pa kërkesë, edhe në rrugë elektronike. Informacioni mund të jepet edhe me gojë, nëse kjo pranohet nga kërkuuesi.

5. Informacioni që vihet në dispozicion pa kërkesë, jepet falas. Kancelari i gjykatës merr masa për të bërë publike numrin e faqeve, për të cilat informacioni përfitohet falas, si dhe rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës.

Neni 10

Informacioni për vendimet gjyqësore

1. Gjykata publikon vendimin e arsyetuar në faqen zyrtare të internetit. Si rregull, vendimet gjyqësore publikohen të anonimizuara, duke fshirë të dhënat personale.

2. Gjykata publikon në faqen zyrtare në internet edhe vendimet e ndërmjetme të çështjes në gjykim, në format të anonimizuar, në rastet kur ka një interes të veçantë nga media.

3. Gjykata i vë në dispozicion përfaqësuesit të medias një kopje fizike të vendimit të anonimizuar, pasi të jetë paraqitur më parë një kërkesë për informim për këtë qëllim, sipas ligjit.

4. Procesit të anonimizimit i nënshtrohen të dhënat personale që lidhen me elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të tilla si:

a) gjeneralitetet e palëve, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë udhëzues, si dhe të personave të tretë, si dëshmitarë ose persona të tjerë të përmendur në parashtrimin e fakteve gjatë procesit;

b) numri personal i identifikimit i pasqyruar në dokumentet e identifikimit, numri i telefonit, adresa postare dhe/ose elektronike, numri i llogarisë bankare, targa e makinës, si dhe çdo e dhënë ose element tjetër që identifikon subjektin e të dhënave personale;

c) të dhënat personale të të miturit;

ç) çdo e dhënë tjetër që pretendohet nga pala në gjykim që cenon dinjitetin dhe jetën private të palëve ose të personave të tretë.

5. Të dhënat e personave juridikë, personave fizikë tregtarë, si dhe institucioneve dhe organeve publike kur ata janë palë në proces, ose kur janë persona të tretë ose të përmendur gjatë parashtrimit të fakteve në vendimin gjyqësor, nuk janë objekt i anonimizimit.

6. Pavarësisht nga sa është parashtruar në pikën 1 të këtij neni, publikimi të dhënave personale të palëve në proces në vendimin gjyqësor në faqen zyrtare elektronike të gjykatës, kryhet i plotë në rastet e mëposhtme, kur:

a) pala jep pëlqimin përpara gjykatës për publikimin e plotë të të dhënave personale, sipas Aneksit A të këtij udhëzuesi. Pëlqimi jepet në seancë gjyqësore ose me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore, përpara përfundimit të hetimit gjyqësor dhe bëhet pjesë e dosjes gjyqësore;

b) i akuzuar është një zyrtar sipas nenit 135, pika 2 të Kushtetutës apo drejtues i institucioneve shtetërore qendrore ose të pavarura, sipas nenit 3, pika 2 të ligjit

“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

c) i akuzuari shpallet fajtor me vendim gjyqësor për një nga veprat penale të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale;

ç) i akuzuari është zyrtar apo punonjës i administratës publike që ushtron funksione të tjera nga ato të përmendura në pikën b) të këtij neni, i cili shpallet fajtor me vendim gjyqësor për veprat penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, si dhe çdo vepër tjetër penale e cila lidhet me funksionin e tij, sipas parashikimeve të Seksionit II të Kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, në rastet e tjera nga ato të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, të neneve 313, 313/a, 313/b të Kodit Penal, si dhe atyre të Seksionit IV të Kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal.

d) i akuzuari shpallet fajtor me vendim gjyqësor për një nga veprat e parashikuara në nenet 73 deri në 79/c të Kodit Penal;

dh) i akuzuari shpallet fajtor për krime seksuale, sipas parashikimeve të seksionit VI të Kreut II të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal;

e) i akuzuari shpallet fajtor me vendim gjyqësor për një nga veprat penale të parashikuara në Kreun X të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal;

ë) i akuzuari shpallet fajtor me vendim gjyqësor për një nga veprat penale të parashikuara në nenet 143 deri në 147 të Kodit Penal.

7. Në të gjitha rastet kur personi shpallet fajtor me vendim gjyqësor për disa vepra penale, ndër të cilat njëra i nënshtrohet rregullave të përjashtimit të parashikuara në pikën 6 të këtij neni, vendimi gjyqësor publikohet i paanonimizuar, sa i përket të dhënave të palës së shpallur fajtor.

Neni 11

Informacioni me kërkesë

1. Informacioni mbi të dhënat personale dhe sensitive të çdo personi, sipas kuptimit që jep ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ose mbi të dhënat që kanë të bëjnë me jetën private të çdokujt, mund të jepet nga gjykata vetëm pasi të vlerësohet rëndësia e të dhënës që kërkohet dhe statusi ligjor i saj.

2. Informacioni sipas pikës 1 kërkohet duke plotësuar një formular aplikimi, i cili mund të plotësohet online në faqen e internetit të gjykatës, ose fizikisht në sportelet e shërbimit të publikut në gjykatë.

3. Aplikimi për informacion me kërkesë i vihet në dispozicion menjëherë gjyqtarit për marrëdhëniet me publikun dhe median nga nëpunësi për marrëdhëniet me publikun dhe median.

4. Vlerësimi i rëndësisë së të dhënës që kërkohet dhe statusit ligjor të saj, bëhet sipas rastit nga kryetari i gjykatës ose trupi gjykuces i çështjes konkrete.

Neni 12

Akresi në dosjet gjyqësore

1. Dosjet gjyqësore aksesohen në çdo kohë nga palët në proces, përfaqësuesit ligjorë të tyre, gjyqtari apo trupa gjykuese e çështjes, prokurori/ët i/e çështjes, si dhe çdo person ose institucion publik tjetër i autorizuar sipas ligjit.

2. Si rregull, personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime studimore, shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, i vihet në dispozicion vetëm kopja e vendimit të plotë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Përfashtim bëjnë rastet kur në përgjigje të një kërkesë të motivuar nga persona të tjerë të përmendur në pikën 1, ku argumentohet pamundësia e realizimit të qëllimit të aksesit vetëm nëpërmjet konsultimit të vendimit, gjykata miraton aksesin fizik në të gjithë dosjen sipas procedurës të parashikuar në nenin 11 të këtij Udhëzuesi.

3. Në çdo rast, personi që kërkon akses është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit duke nënshkruar deklaratën përkatëse.

KAPITULLI IV

RREGULLA SPECIFIKE PËR INFORMIMIN E MEDIAS MBI PROCESIN GJYQËSOR

Neni 13

Pjesëmarrja në seancën gjyqësore

1. Seancat gjyqësore publike janë të hapura për publikun dhe median.

2. Përfaqësuesit e medias mund të ndjekin procesin gjyqësor pa bërë komente dhe brenda rregullave që diktohen nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues për zhvillimin e gjykimit të drejtë.

3. Në rastet kur salla e gjykimit nuk ka vende të mjaftueshme për sistemimin e të gjithë të interesuarve për të ndjekur seancën, nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun, nën kujdesin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, vendos lejimin e pjesëmarrësve në sallë, sipas kësaj radhe:

- a. subjektet në gjykim;
- b. familjarët dhe të afërmit;
- c. përfaqësuesit e medias.

Kur numri i familjarëve është më i madh sesa numri i vendeve në sallë, nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun, nën kujdesin e gjyqtarit/ kryesuesit të trupit gjykues cakton një kuotë vendesh në sallë për familjarët, në mënyrë të tillë që të ruajë edhe një kuotë përfaqësuese për përfaqësuesit e medias.

4. Përfaqësuesi i medias, gjatë seancës, lejohet të raportojë përmes mesazheve të shkruara nga pajisje telefonike dhe/ose kompjuterike, vetëm pasi më parë ka marrë autorizimin e kryetarit të seancës. Në çdo rast, këto pajisje duhet të përdoren pa zë.

5. Nëse përdorimi i pajisjeve telefonike dhe/ose kompjuterike, apo pajisjeve të tjera gjatë seancës, pengon administrimin e duhur të drejtësisë, ose rendin dhe rregullin e procesit gjyqësor, gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues, me urdhër, mund të kufizojë ose të ndalojë përdorimin e tyre gjatë seancës.

6. Rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim për qëndrimin në sallën e gjyqit vlejnë, pa asnjë përjashtim, për përfaqësuesit e medias dhe punonjësit e operatorëve radiotelevizivë.

Neni 14

Administrimi i kërkesave për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave gjyqësore nga media

1. Seancat gjyqësore mund të regjistrohen dhe transmetohen në media, me kërkesë të mediave ose me nismën e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues. Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.
2. Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë, tërësisht ose pjesërisht, me urdhër të gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, i cili vendos për çështjen objekt gjykimi. Çdo regjistrim tjetër është i ndaluar.
3. Seancat gjyqësore, për të cilat përfaqësuesit e medias dhe fotoreporterët kërkojnë imazhe filmike, ndiqen me paraqitjen e kërkesës sipas formularit në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzuesi. Formularët bëhen publikë në faqen e internetit dhe/ose në mënyrë të printuar në mjediset e gjykatës ku bëhet kërkesa. Kërkesa mund të plotësohet edhe *online* kur ky shërbim ofrohet nga gjykata përkatëse.
4. Kërkesa për pjesëmarrje i paraqitet nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe median, jo më vonë se njëzet e katër orë para orës së deklaruar për fillimin e seancës gjyqësore.
5. Nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun ia paraqet menjëherë kërkesën e regjistruar kryesuesit të trupit gjykues, duke vënë në dijeni edhe kryetarin e gjykatës dhe gjyqtarin për marrëdhëniet me publikun dhe median.
6. Gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues ka të drejtën të:
 - a) lejojë ose ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës;
 - b) lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesshëm të seancës;
 - c) ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore, që ishte lejuar më parë të regjistrohej.
7. Kërkesa pranohet ose refuzohet plotësisht ose pjesërisht, vetëm në çelje të seancës gjyqësore, kur të pranishëm në sallë janë edhe përfaqësuesit e medias që bën kërkesën. Kjo pjesë e seancës është e regjistrueshme dhe transmetohet pa asnjë kufizim.
8. Kërkesa mund të refuzohet vetëm për këto arsye:
 - a) Seanca gjyqësore zhvillohet me dyer të mbyllura.
 - b) Kur një nga subjektet në gjykim nuk dëshiron të regjistrohet seanca. Ky rregull nuk vlen për prokurorin dhe avokatin.
 - c) Çmohet nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues se prania e kamerave ndikon ecurinë e procesit të rregullt gjyqësor.
9. Për të siguruar rendin e duhur të procesit, gjykata mund të vendosë që t'i lejohej akses në sallë një numri të kufizuar ekipesh me kamera dhe të përcaktojë si kusht që ata të jenë pjesë në një skemë shpërndarjeje të të tjerët që nuk kanë akses. Kamerat vendosen gjithmonë në fund të sallës dhe në mënyrë statike. Ndalohet përdorimi i tyre në mënyrë të lëvizshme.

10. Kur seanca gjyqësore regjistrohet me kamera nga vetë gjykata, kamerat e medias elektronike nuk lejohen të filmojnë. Në këtë rast, shërbimi i marrëdhënieve me median dhe publikun nën drejtimin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, shpërndan pamjet filmike dhe/ose audio nga seanca, ose lejon transmetimin e plotë të saj nga mediat e vendosura nga një mjedis i posaçëm jashtë sallës së gjyqit që administrohet nga ky shërbim.

Neni 15

Zbatimi

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen gjyqtari për marrëdhëniet me publikun dhe median dhe nëpunësi për marrëd

**DEKLARATË PËLQIMI
PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____, në _____, i/e identifikuar me kartën e identitetit nr. _____, madhor/e dhe me zotësi të plotë për të vepruar, pasi u njoha me informacionin e dhënë nga "Kontrolluesi i të dhënave", Gjykata e _____, bazuar në nenin 6 të ligjit 9887/10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar si dhe gjurmën a) të pikës 6 të nenit 10 të vendimit nr. 716 datë 06.12.2023 "Udhëzuesi standard i marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median", të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si "subjekt i të dhënave personale" deklaroj si më poshtë:

Jam informuar që, Gjykata e _____, në kuadër të procesit gjyqësor që zhvillohet pranë saj, ku unë jam i përfshirë në cilësinë e palës në proces/personit të tretë, mbledh, përdor dhe përpunon të dhënat e mia personale. Në përputhje me gjurmën a) të pikës 6 të nenit 10 të vendimit nr. 716 datë 06.12.2023 "Udhëzuesi standard i marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, deklaroj:

☐ Dhënie e pëlqimit
e pëlqimit

☐ Mosdhënie

për qëllimin e publikimit të të dhënave të mia në vendimin gjyqësor që gjykata publikon në faqen e saj zyrtare elektronike si dhe në portalin elektronik www.gjykata.gov.al.

(Emër Mbiemër)
Nënshkrimi

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____, në _____, i/e identifikuar me kartën e identitetit nr. _____, madhor/e dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor për qëllime të ndryshme nga ai i përcaktuar në kërkesën datë _____.20____, drejtuar gjykatës me qëllim aksesin në dosjen gjyqësore _____ dhe të mos i transmetoj personave të paaautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga aksesin në këtë/këto dosje gjyqësore përveç nëse autorizohem shprehimisht me shkrim nga subjekti/et i/e të dhënave apo kjo kërkohet me ligj.

Unë jam në dijeni se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, rregullohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe se shkelja e detyrimeve që burojnë sipas dispozitave të këtij ligji është subjekt i sanksioneve të përcaktuara në të.

Unë deklaroj se do të trajtoj si konfidenciale të dhënat personale dhe do t'i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

Unë nuk do të përdor dhe/ose përhap asnjë të dhënë personale për të cilën marr dijeni gjatë aksesit në dosjen/t gjyqësore për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e deklaruara në kërkesën drejtuar gjykatës.

Detyrimet sipas kësaj deklarate kanë efekt të pacaktuar në kohë.

Emër Mbiemër, Nënshkrimi, data

NR	INSTITUCIONI	GJYQITARI PËR MEDIAN	NËPUNËSI PËR MARRËDHËNIEN ME MEDIAN DHE PUBLIKUN	ADRESA E-MAIL
1	Gjykata e Lartë		Ida Vodica	ida.vodica@gjykataclarte.gov.al ; gjykataclarte@gmail.com ;
2	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	Edlira Petri	Jonida Capo	petri.apel@gmail.com ; jonida.capo@gjykata.gov.al ; support@gjykatacapellitirne.al ;
3	Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	Saida Dollani	Enida Demiraj	saida.dollani@gjykata.gov.al ; enida.demiraj@gjykata.gov.al ;
4	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berar	Ardiola Çela	Fiqirete Salla	ardiolaacela@gmail.com ; gjykataberar@gmail.com ;
5	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë	Mevlute Çaushti	Elsi Çaushti	mevlutecaushti@outlook.com ; elsi.caushti@gjykata.gov.al ;
6	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	Besjana Garxenaj	Abela Lame	besjana_garxenaj@yahoo.com ; abela.lame@gjykata.gov.al ; zmp.gjykataurrtchidurres@gjykata.gov.al ;
7	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	Ardit Kuka	Manjola Kune	ardit.kuka@gjykata.gov.al ; ardit.kuka@live.com ; manjola.kune@gjykata.gov.al ;
8	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	Alfred Konomi	Secla Fili	alfred.konomi@gjykata.gov.al ; secla.fili@gjykata.gov.al ;
9	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë	Marjola Beluli	Gentiana Lili	marjola.beluli@gjykata.gov.al ; gentiana.lili@gjykata.gov.al ; zmp.urrtchigjirokastr@gjykata.gov.al ;

10	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	Ervin Sulaj	Emis Grabocka	ervin.sulaj@gjykata.gov.al ; emis.grabocka@gjykata.gov.al ; info.gjykatakorce@gjykata.gov.al
11	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	Suada Kurti	Arben Sokoli	suada.kurti@gjykata.gov.al ; arben.sokoli@gjykata.gov.al
12	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	Renis Sheshi	Adelina Dedgjionaj	renis.sheshi@gjykata.gov.al ; adelina.dedgjionaj@gjykata.gov.al ; njofline.gjykatalezhe@gjykata.gov.al
13	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	Dejvi Çelçima	Ardit Dauti	celcimadejvi@gmail.com ; ardit.dauti@gjykata.gov.al ; Orgent.Nazaj@gjykata.gov.al ; orgent@live.com ;
14	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	Orgent Nazaj	Visar Halvatori	visar.halvatori@gjykata.gov.al ; info.gjykata.shkoder@gjykata.gov.al ; njofline.gjykata.shkoder@gjykata.gov.al ;
15	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	Migena Laska	Ola Ismaili	officeofjudge@gmail.com ; oismaili@gjykatatirana.gov.al ; infoceville@gjykatatirana.gov.al ; infoopenale@gjykatatirana.gov.al ;
16	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	Emirjana Dimo	Etelea Doraci	emirjana.dimo@gjykata.gov.al ; kontakt.gjykatartehivlore@gjykata.gov.al ; frida.gani@gjykata.gov.al
17	Gjykata e Posacme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin	Erjon Bani	Dinora Aleksis	erjon.bani@gjykata.gov.al ; dinora.aleksi@gjykata.gov.al ; zmp@gjkr.gov.al
18	Gjykata Administrative e Apelit	Blerona Hasa	Vilma Yzo	blerona_hasa@yahoo.co.uk ; vilma.yzo@gjykata.gov.al

				info@gjykataadministrativecapellit.al
19	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		Ajrona Firqaj	ajrona.firqaj@gjykata.gov.al
20	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		Eglantina Quko	Eglantine.quko@gjykata.gov.al

NR	INSTITUCIONI	GJYQTARI PËR MEDIAN	NËPUNËSI PËR MARRËDHËNIEN ME MEDIAN DHE PUBLIKUN	ADRESA E-MAIL
1	Gjykata e Lartë		Ida Vodica	ida.vodica@gjykataelarte.gov.al; gjykataelarte@gmail.com; petri.apel@gmail.com; jonida.capo@gjykata.gov.al;
2	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	Edlira Petri	Jonida Capo	petri.apel@gmail.com; jonida.capo@gjykata.gov.al; support@gjykatacapelitiranc.al;
3	Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	Saida Dollani	Enida Demiraj	saida.dollani@gjykata.gov.al; enida.demiraj@gjykata.gov.al;
4	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	Ardiola Çela	Marsida Koroni	marsida.koroni@gjykata.gov.al; gjykataberat@gmail.com;
5	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	Mevlute Çausi	Elsi Caushi	mevlute.caushi@gjykata.gov.al; elsi.caushi@gjykata.gov.al;
6	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	Besjana Garxenaj	Abela Lame	besjana_garxenaj@yahoo.com; abela.lame@gjykata.gov.al; zmp.gjykatatirethitdurrës@gjykata.gov.al;
7	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	Ardit Kuka	Manjola Kume	ardit.kuka@gjykata.gov.al; ardit.kuka@live.com; manjola.kume@gjykata.gov.al;
8	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	Alfred Konomi	Stela Fili	alfred.konomi@gjykata.gov.al; stela.fili@gjykata.gov.al;
9	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë	Orinda Lloshi	Gentiana Lili	orinda.lloshi@gjykata.gov.al; gentiana.lili@gjykata.gov.al; zmp.rrethigjirokastrë@gjykata.gov.al;
10	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	Gentiana Shukullari	Emis Grabocka	gentiana.shukullari@gjykata.gov.al; emis.grabocka@gjykata.gov.al; info.gjykatakorçë@gjykata.gov.al;
11	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	Suada Kurti	Arben Sokoli	suada.kurti@gjykata.gov.al; arben.sokoli@gjykata.gov.al;
12	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	Renis Sheshi	Vitore Mhilli	renis.sheshi@gjykata.gov.al; vitore.mhilli@gjykata.gov.al; njoftime.gjykatalezhe@gjykata.gov.al;
13	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	Edona Vajushi	Ardit Dauti	edona.vajushi@gmail.com; ardit.dauti@gjykata.gov.al;
14	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	Orgent Nazaj	Visar Halvatori	orgent.nazaj@gjykata.gov.al; visar.halvatori@gjykata.gov.al; info.gjykata.shkodër@gjykata.gov.al; njoftime.gjykata.shkodër@gjykata.gov.al;
15	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	Migena Laska	Ola Ismaili	officeofjudge@gmail.com; oismaili@gjykatatirana.gov.al; infocivile@gjykatatirana.gov.al; infopenale@gjykatatirana.gov.al;

16	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	Dorina Stroka	Etleva Doraci	dorina.stroka@gjykata.gov.al; kontakt.gjykatarrethivlore@gjykata.gov.al frida.gani@gjykata.gov.al
17	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin	Erjon Bani	Elsa Lita	erjon.bani@gjykata.gov.al elsa.lita@gjykata.gov.al; zmp@gjkr.gov.al;
18	Gjykata Administrative e Apelit	Blerona Hasa	Vilma Yzo	blerona_hasa@yahoo.co.uk; vilma.yzo@gjykata.gov.al; info@gjykataadministrativecapelit.al;
19	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë		Arjona Firaj	arjona.firaj@gjykata.gov.al;
20	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë		Eglantina Quka	eglantina.quka@gjykata.gov.al;

FORMULAR PËR PËRFAQËSUESIT E MEDIAS
KËRKESË PËR REGJISTRIMIN/TRANSMETIMIN E IMAZHEVE FILMIKE TË SEANCËS
GJYQËSORE

Bazuar në vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median"

TË DHËNAT E PËRFAQËSUESIT TË MEDIAS		
Emër Mbiemër: Z./Znj.	Adresa postare: Adresa elektronike: Nr. Tel:	Data e kërkesës:

TË DHËNAT E SEANCËS GJYQËSORE		
Data e seancës	Palët	Gjyqtari

Regjistrim i imazheve filmike të seancës gjyqësore	☐
Regjistrim dhe transmetim i drejtpërdrejtë i imazheve filmike të seancës gjyqësore	☐
Fotografimi i seancës gjyqësore	☐

Parimet e Marrëdhënies të publikut dhe median

Marrëdhënia e gjykatës me publikun dhe median bazohet në parimet e aksesit të barabartë në gjykata, karakterit publik të procesit gjyqësor, hapjes maksimale të veprimtarisë gjyqësore ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit si dhe prezumimit të pafajësisë.

Seancat gjyqësore publike janë të hapura për publikun dhe median. Përfaqësuesit e medias mund të ndjekin procesin gjyqësor pa bërë komente dhe brenda rregullave që diktohen nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues për zhvillimin e gjykimit të drejtë.

Përfaqësuesi i medias, gjatë seancës, lejohet të raportojë përmes pajisjeve telefonike dhe/ose, kompjuterike dhe të dërgojë mesazhe të shkruara përmes tyre. Në çdo rast këto pajisje duhet të përdoren pa zë.

Gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues me urdhër mund të kufizojë ose të ndalojë përdorimin e pajisjeve telefonike dhe/ose kompjuterike apo pajisje të tjera gjatë seancës nëse përdorimi i tyre pengon administrimin e duhur të drejtësisë ose rendin dhe rregullin e procesit gjyqësor.

Seancat gjyqësore mund të regjistrohen dhe transmetohen në media me kërkesë të mediave ose me nismën e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues. Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.

Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë, tërësisht ose pjesërisht, me urdhër të gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, i cili vendos për çështjen objekt gjykimi. Çdo regjistrim tjetër është i ndaluar.

Kërkesa për pjesëmarrje i paraqitet nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe median jo më vonë se njëzet e katër orë para orës së deklaruar për fillimin e seancës gjyqësore.

Gjyqtari/ kryesuesi i trupit gjykues ka të drejtën të: a) lejojë ose të ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës; b) lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesshëm të seancës; c) ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore që ishte lejuar më parë të regjistrohej.

Kërkesa pranohet ose refuzohet plotësisht ose pjesërisht vetëm në çelje të seancës gjyqësore, kur të pranishëm në sallë janë edhe përfaqësuesit e medias që bënë kërkesën. Kjo pjesë e seancës është e regjistrueshme dhe transmetohet pa asnjë kufizim.

Kërkesa mund të refuzohet vetëm për këto arsye: a) Seanca gjyqësore zhvillohet me dyer të mbyllura. b) Kur një nga subjektet në gjykim nuk dëshiron të regjistrohet seanca. Ky rregull nuk vlen për prokurorin dhe avokatin. c) Çmohet nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues se prania e kamerave ndikon ecurinë e procesit të rregullt gjyqësor.

Për të siguruar rendin e duhur të procesit, gjykata mund të vendosë që t'i lejohet akses në sallë një numri të kufizuar ekipesh me kamera dhe të përcaktojë si kusht që ata të jenë pjesë në një skemë shpërndarjeje tek të tjerët që nuk kanë akses. Kamerat vendosen gjithmonë në fund të sallës dhe në mënyrë statike. Ndalohet përdorimi i tyre në mënyrë të lëvizshme.

Kur seanca gjyqësore regjistrohet me kamera nga vetë gjykata, kamerat e medias elektronike nuk lejohen të filmojnë. Në këtë rast, shërbimi i marrëdhënieve me median dhe publikun nën drejtimin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, shpërndan pamjet filmike dhe/ose audio nga seanca, ose lejon transmetimin e plotë të saj nga mediat të vendosura nga një mjedis i posaçëm jashtë sallës së gjyqit që administrohet nga ky shërbim.

Cështje civile

Cështjet Penale

Kohëzgjatja e Cështjeve

Vepra Sekondare dhe Denime me Kusht

Dhuna

Kalendari i seancave

Informacion mbi shortin

Lajmërime për publikun

Publikime

Pasqyra e shtypit

Njoftime

Njoftime për publikun

Njoftime të tjera

Njoftime për median



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e
Juridiksionit të Përgjithshëm
Durrës

Cështje te paperfunduara deri ne daten: 4/9/2025

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri ne 60	800	12.04%
61 deri ne 120	521	7.84%
121 deri ne 180	155	2.33%
181 deri ne 240	156	2.35%
241 deri ne 300	194	2.92%
301 deri ne 360	147	2.21%
361 deri ne 420	109	1.64%
421 deri ne 480	61	0.92%
481 deri ne 540	62	0.93%
541 deri ne 600	36	0.54%
601 deri ne 660	44	0.66%
661 deri ne 720	29	0.44%
721 ose me shume	4331	65.18%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE STATISTIKORE
TË DHËNA TË HAPURA**

**REFERUAR ANALIZËS SË PUNËS
TË GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
Durrës
GJATË VITIT 2024**

Durrës, 24 JANAR 2025

Programi i Transparencës

Hyrje

Rreth autoritetit

Kuadri ligjor rregullator

Tekstet e plota

E drejta p

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që
veprojnë mbi AP

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat
financiare të AP

Im
prokur
konce

Shërbimet që ofrohen nga AP

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime
lidhur me procesin e hartimit të akteve
ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje
me ushtrimin e funksioneve të AP

Sistemi i mb

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga
AP

Informac
shpesh dh

- Koordinator: Abela Lame
- E-mail: zmp.gjykatarrëthitdurrës@gjykata.gov.al, abela.lame@gjykata.gov.al
- Nr. i gjelbër
- Tel: +355 52 234362
- Adresa: Lagjia Nr.2 Rruga "Aleksandër Goga" Durrës
- Orari: 08:00 - 16:00
- Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)

Për ndonjë koment, pyetje ose vëzhgim që mund të kenë, ju lutem plotësoni formën më poshtë:

Emri Mbiemri

Numri i telefonit

Email

Fax

Komenti juaj max: 400

Dërgo

Pastro